



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr prot. 06-43531/2024

Datë: 26.12 /2024

Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 2, shkronjën e) të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 40 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Klinës / 2010, Nenit 14 të Rregullores (QRK) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit para universitar, me kërkesën e Drejtorisë për Arsim me nr.01-06-40654, të datës 05.12.2024, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e rregullt të mbajtur me datën: 20.12.2024, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet shkollore të Komunës së Klinës

1. Formohet Komisioni për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet shkollore të Komunës së Klinës, mandati i Komisionit do të jetë i vlefshëm sipas Rregullores (QRK) Nr.19/2024.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 1. Astrit Muhaxheri - Zyrtarë në DKA
 2. Hake Berisha – Eksperte e Arsimit
 3. _____ nga MASHT-i
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Arsim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.

Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi

